



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

Numri i lëndës: 2024:005927  
Datë: 18.10.2024  
Numri i dokumentit: 06320175

PPP.nr. 135/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit R. N., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, avokat me seli në Gjakovë, kundër debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson Qëndresa Bytyqi Hoxha, zyrtare ligjore, sipas dokumentit përmbartimor për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori i përmbartimit kundër Urdhrit për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.1521/24, të datës 03.07.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 18.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri i Përmbartuesit Privat Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, me numër P.nr.1521/24, të datës 03.07.2024, sa i përket kërkesës së kreditorit që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbartim, debitori t'ia paguajë shumën prej 28.08 euro, në emër të TVSH-së prej 18%.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri i Përmbartuesit Privat Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, me numër P.nr.1521/24, të datës 03.07.2024, për pjesën me të cilin është caktuar përmbartimi në bazë të dokumentit përmbartimor, lidhur me pagesën në emër të borxhit kryesor në shumën prej 632.00 euro, me kamatë ligjore 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 15.12.2023 e deri në pagesën definitive, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore

shumën prej 124.00 euro si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës përmbartimore në shumën prej 156.00 euro.

- III. Obligohet debitori, që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ja paguaj kreditorit shumën prej 156,00 €, në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij Aktvendimi, nën kërcënim të përmbartimit.

### A r s y e t i m

Përmbartuesi Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit R. N., nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, avokat me seli në Gjakovë, ka lëshuar urdhër me numër P.nr.1521/24, i datës 03.07.2024, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjakovë me numër C.nr.2429/23 të datës 29.04.2024, i plotfuqishëm me datë 30.05.2024.

Konform aktgjykimit të lartcekur, të Gjykatës Themelore në Gjakovë me numër C.nr.2429/23 të datës 29.04.2024, kreditori ka parashtruar propozim për përmbartim. Me propozimin për përmbartim ka kërkuar që të caktohet përmbartimi ashtu që të detyrohet debitori Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që kreditorit t'ia paguaj borxhin kryesor shumën prej 632.00 €, në emër të shpenzimeve procedurës kontestimore shumën prej 124.00 €, si dhe shumën prej 156.00 € në emër të shpenzimeve përmbartimore.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit. Në prapësim debitori ka theksuar se e kundërshton në tërësi propozimin për përmbartim si dhe urdhrin për përmbartim si tërësisht i pa bazuar. Gjithashtu, e kundërshton edhe pjesën e propozimit mbi shpenzimet e procedurës përmbartimore, ku kreditori ka kërkuar edhe 18 % të TVSH-së, për shkak se kërkesat lidhur me këto shpenzimet janë në kundërshtim me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve. Në fund i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin për përmbartim ta shfuqizon, gjegjësisht ta hedh poshtë si të pabazuar.

Kreditori, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur përgjigje në prapësim duke i propozuar gjykatës që ta refuzoi si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe ta aprovoj si të bazuar Urdhrin

Përmbartimor të lëshuar nga Përmbartuesi Privat dhe ta obligoi debitorin që kreditorit të ja paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, në shumë prej 156.00 €. Ndërsa sa i përket shpenzimeve në emër të TVSH-së prej 18%, i njëjti ka theksuar se ajo është bazuar në Ligjin për Tatim në Vlerën e Shtuar Nr. 05/L-037, andaj pretendime e debitorit lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të procedurës përmbartimore janë të pa bazuara.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe ato të kreditorit në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e shfuqizuar urdhrin pjesërisht Urdhrin e Përmbartuesit Privat Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, me numër P.nr.1521/24, të datës 03.07.2024, sa i përket kërkesës së kreditores që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbartim debitori t'ia paguajë shtesën e shumës prej 28.08 euro në emër të TVSH-së prej 18%, me arsyetimin se këto shpenzime nuk i përkasin dispozitivit të vendimit gjyqësor me të cilin është paraqitur propozimi për përmbartim, e as nuk janë të parapara në Tarifën e Odës së Avokatëve Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitivit të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.135/2024, me 18 Tetor 2024

Gj y q t a r j a  
Blerina KURTAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.